



KESHILLI QARKUT SHKODER

**PROJEKT DOKUMENTI I PARË I
PROGRAMIT BUXTETOR AFATMESEM
2023 – 2025**

1. Vështrim i përgjithshëm

1.1 Situata e Këshillit të Qarkut Shkodër

Misioni i Këshillit të Qarkut Shkodër është të zhvillojë një qeverisje efikase në të gjithë territorin e tij, të qëndrueshëm nëpërmjet koordinimit dhe harmonizimit të politikave të njësive të qeverisjes vendore duke rritur cilësinë në zhvillimin e territorit, dhe duke përcaktuar edhe implementuar shërbime eficente për ti realizuar në forma sa me të përshtatshme.

Qëllimi i K. Q. SH ka karakter Profesional me obligim demokratizimin e mëtejshëm të jetës së komunitetit të qarkut tonë dhe veriut në përgjithësi duke ndërmarrë nisma konkrete si dhe është dhe do të jetë organizëm në mes njësive të qeverisjes vendore dhe pushtetit qendror, duke mbështetur sa më shumë praktikat e mira duke krijuar prioritetet e nevojshme të ndërhyrjeve të ndryshme.

K. Q. SH, punon në zgjidhjen e problemeve të përbashkëta, forcimin e bashkëpunimit mes bashkive si dhe rritjes se performancës se tyre si dhe aftësisë observuese të projekteve të donatoreve apo programeve duke i realizuar ato konkretisht si shërbime të domosdoshme ndaj komuniteteve apo target grupeve të ndryshme.

Qëllim kryesor i K. Q. SH. do të jetë qeverisja e mirë dhe e suksesshme në nivelin lokal, duke marre përgjegjësinë si dhe funksione të deleguara në të gjitha fushat shoqërore që i përkasin dhe do të ketë synim harmonizimin e niveleve të ndryshme të qeverisjes qëndrore si dhe shhangien e paralelizmave të panevojshme, pavarësish nga adresohen, sidomos një rol të veçantë do të ketë edhe në procesin e integrimit.

K. Q. SH do të forcojë bashkëpunimin dhe aderojë me asociacionet simotra evropiane ndërkombëtare si dhe do të bazohet në Kartën Evropiane të Autonomisë Lokale dhe Rajonale (neni 4, artikulli 6) ku thuhet: bashkësive lokale duhet t'u kërkohet mendimi, brenda mundësive, në kohën e duhur dhe në mënyrë të përshtatshme, gjatë proceseve të planifikimit e marrjes së vendimeve për çështjet që u përkasin drejtpërsëdrejti, ato duhen respektuar.

Marrëveshjet që do të nënshkruaj Këshilli i Qarkut me Bashkitë si dhe me entet Qeveritare do të jenë baza juridike e të gjitha veprimeve tona, por për të qenë efektivë në ndërtimin të strukturave dhe të strategjisë *sipas ndarjes se re territoriale administrative, qe te nxisë këto procese te cilat kane nevoje për decentralizim, me shume efektshmëri financiare e veprim autonom te koordinuar sa me drejt*. Ne, nga ana jonë, jemi plotësish të gatshëm të bashkëpunojmë në mënyrën më korrekte.

Veprimitaria e Këshillit të Qarkut dhe strukturave të tij administrative nuk duhet të vijë duke u stopuar e në gjendje pritmërie, por duhet t'i jepet një frymëmarrje te re jo vetëm si hapësire territoriale, por duke i dhënë qarqeve dhe kompetenca mbi kryerjen e shërbimeve te domosdoshme në koordinimin e punëve ndërmjet qeverisjes Qëndrore, Bashkive, Agjencive të zhvillimit e donatorëve të tjerë për të realizuar një bashkëpuni sa më të harmonizuar dhe domethënës.

1.2 Çështje kryesore për projektet dhe politikat e qarkut.

Këshilli i Qarkut Shkodër duke pasur prioritet harmonizimin e politikave te zhvillimit rajonal e konsideron te rendesishem te kontribuoje në rehabilitimin e infrastructures. Keshilli i Qarkut Shkoder në objektivat e tij ka konsideruar dhe konsideron të rëndësishme zhvillimin

ekonomik të zonave të territorit, duke lehtesar banoret e saj për të pasur akses ne tregun rajonal të produkteve si dhe në tregun e punës.

Koncepti Strategjik i Zhvillimit Rajonal te Qarkut Shkoder ne masat e saj per Infrastrukturen dhe Sherbimet, Turizmin dhe Bujqesine parashikojne permiresimin e infrastruktures dhe sherbimve per te pasur akses ne tregun e rajonal me produktet tipike te zones. **Qarku Shkodër synon qe zhvillimi i infrastrukturës dhe shërbimeve në rajon te shërbeje si mbështetës i zhvillimit të qëndrueshmë rajonal për përbushjen e nevojave dhe prioriteteve të grupeve të ndryshme sociale.** Këto ndërhyrje, veçanërisht në aspektin e infrastrukturës fizike do të përmirësojnë cilësinë e jetesës në zonat rurale e urbane dhe do të mbrojnë rajonin nga fatkeqësitë natyrore.

Qarku i Shkodrës ne synimin për te qene qark lider do e mbështesë veprimin e vet kryesisht ne zhvillimin e menaxhimin e ndërveprimit me publikun, njësite e qeverisjes ne nivele te ndryshme dhe ne nivele ndërkombëtare. Zhvillimi dhe menaxhimi i shërbimeve publike fokusohet kryesisht në përgatitjen e planit hapësinor për rajonin dhe ne planëzimin urban për të gjitha vendbanimet në qark, përfshire projekte për rrugët, zonat e ndërtimit, zonat e gjelbra, infrastrukturën mjedisore dhe përpunimin e mbetjeve urbane e telekomunikacionin. Kjo masë bazohet në faktin se tashmë ekziston një traditë në kuadër të shërbimeve publike. Nga ana tjeter është evidente nevoja, e zhvillimit të mëtejshëm dhe menaxhimit me efektiv të këtyre shërbimeve publike. Veprimet kanë për qëllim krijimin kushteve të favorshme përritjen e cilësisë së shërbimeve.

Gjithashtu ne dokumentin strategjik te rishikuar “**Skenaret e Zhvillimit Nenrajonal te Qarkut Shkoder**” ne fushen prioritarë 2 si dhe ne masat e tij parashikohen nderhyrje ne infrastruktura qe kane per qellim permiresimin e projekteve dhe infrastruktures ndermjet Njesive te Qeverisjeve vendore dhe Njesive administrative ne territorin e Qarkut Shkoder. Ky dokument synon po ashtu të *harmonizojë* edhe rekondiminet të cilat burojnë nga dokumente të tjera strategjike të cilat adresojnë çështjet e qeverisjes rajonale apo Qarkun Shkodër specifisht; duke filluar nga dokumente strategjike që japos udhëzime për qeverisjen rajonale në vendet e Europës jug-lindore dhe Ballkanit perëndimor deri tek dokumentet sektoriale të cilat adresojnë një çështje të caktuar në Qarkun Shkodër.

1.3 Informacion finansiar Kryesor

Burimi i informacionit: Nxjerrë nga Instrumenti i PlanifikimitFinanciar

Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të miratuara si dhe në transfertat e pakushtëzuara të përcaktuara në vlerë absolute në Udhëzimin nr.8, datë 28.02.2022 të Ministrisë së Financave, janë përgatitur tavanet buxhetore përgatitore të shpenzimeve për PBA-në 2022-2024 në nivel programi.

Programet për të cilat do të planifikohen shpenzimet buxhetore për tre vitet e ardhshme 2023-2025 sipas IPF, do të janë;

1. **Programi “Planifikim, menaxhim, administrim”**
Programi 01110
Programi 01160
2. **Programi “Rrjeti Rrugor Rural”**
Programi 04520
3. **Programi “Mbështetje për Zhvillim e Ekonomik”**
Programi 04130
4. **Programi “Furnizimi me ujë dhe Kanalizime”**
Programi 06370

5. Programi “Përkujdesja sociale”
Programi 10430



Ne Formatin (D1) të Instrumentit të Planifikimir Financiar, janë pasqyrur limitet e shpenzimeve te ndara sipas programeve buxhetore.

Edhe ne vendosjen e tavaneve përgatitore të shpenzimeve sipas programeve, vazhdojnë te mbeten prioritite investimi i nisur për Ujësjellësin e Muriçanit si dhe investimet per te cilat do të propozohen nga anëtarët e Këshillit të Qarkut dhe Kryetarët e Bashkive të qarkut Shkodër sipas prioriteteve të vendosura dhe të miratuara në KB-të respektive.

1. Programi “Planifikim, menaxhim, administrim”
Programi 01110

Ky program përfshin **Programin 01110 “Planifikimin, menaxhimin e administrim”** për administratën e institucionit tone me fonde te pakushtezuaara si dhe **Programin 01160 “Planifikimin, menaxhimin e administrim”** për DAMT, funksion i deleguar pranë institucionit tone, për të cilin akordohen fondet nga Ministria e Brendshme me transferte të kushtëzuar, të detajuara për paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative për 6 punonjësit e kësaj strukture.

Në këtë program, siç shifet ne tabelën e tavaneve, përfshihen shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore per 3 vitet e ardhshme 2023-2025.

Në shpezimet korrente , pasqyrohen tavonet e shpenzimeve për shpenzimet operative, art.602, transfertat e brendshme, ato sipas VKM-ve dhe sipas VKQ-se,art.604, shpenzimet per transfertat e jashtme art. 605 si dhe transfertat per individet art.606 për 3 vitet e ardhshme 2023-2025.

Për DAMT, planifikimi është bërë duke u mbështetur në fondet e akorduara ne vitin 2022.

Në shpenzimet kapitale të këtij Programi janë pasqyruar vlerat e planifikuara për paisje e orendi zyre sipas nevojave nder vite si dhe planifikimi i bërë për investimin “Varrezat publike të qytetit Pukë”.

2. Programi “Rrjeti Rrugor Rural”
Programi 04520

Në tabelën e tavaneve, për këtë program, janë pasqyruar vlera të investimeve që parashikohen të kryhen në rikonstruksione rrugësh sipas tavaneve të paraqitura në tabelen D1 te IPF.

3. Programi “Mbështetje për Zhvillim e Ekonomik”
Programi 04130

Meqë në vitin aktual kemi planifikuar fonde për projekte në fushën e turizmit dhe meqë ne si institucion kemi aplikuar në disa projekte kryesishët në ketë fushë, kemi planifikuar fonde për 3 vitet e ardhshme, për bashkëfinancime apo mbulim kosto tvsh-je, kusht për vazhdimësinë e tyre.

4. Programi “Furnizimi me ujë dhe Kanalizime”
Programi 06370

Në këtë program është planifikuar shuma për invesimin “Ndërtim i ujësjellësit Muriqan” për të cilin është hartuar projekt i këtij investimi në vlerën totale 98,181 mijë lekë.

Ky nvestim vazhdon të mbetet prioritet i KQShkoder ,pe të cilin jane planifikuar fonde ne vitin 2022 rreth 60% të vlerës së investimit, në vitin 2023 janë planifikuar rreth 25% të% të vlerës së investimit dhe në vitin 2024 rreth 15% të vlerës së investimit.

5. Programi “Përkujdesja sociale” Programi 10430



Në PBA-ne 2023-2025, nuk kemi planifikuar fonde nga transfreta e pakushtezuar në këtë program, pasi qe në vitin 2020, Ministria e shendetisës së mbrojtjes sociale, na akordon fonde te kushtëzuara per mbështetje financiare per Shëpinë Familje FACIBENi në Shkodër, në baze te projektit të paraqitur për këte mbeshtetje.

2. *Orjentimi afatgjatë i KQShkodër*

2.1 *Strategjia e Zhvillimit Afatgjatë*

Qarku Shkodër ka një popullsi prej rreth 200,000 banorësh, përbëhet nga tre rrethe kryesore Shkodër - Malësi e Madhe-Pukë, me 5 Bashki me një total prej 272 fshatrash. Me një ekosistem të larmishëm liqenor/ lumor/detar dhe pika më e afërt e transitit drejt veriut të Gadishullit të Ballkanit dhe tregun e Bashkimit European (me rrugë tokësore dhe hekurudhore), qarku Shkodër manifeston të gjitha parakushtet e një zone të rëndësishme tregu dhe tranziti, si edhe të një qëndre të rëndësishme ekonomike dhe industriale të Shqipërisë.

Këshilli i Qarkut Shkodër ka bërë përpjekje të mëdha ndër vite në hartimin e dokumentave strategjike. Një numër dokumentash strategjike janë tashmë të gatshme në rajon, përmendim këtu:

- *Planin Rajonal Hapësinor*, hartuar me ekspertizën e “Eptisa International Group” i cili i referohet metodave që do të përdorën nga sektori publik për të ndikuar në shpërndarjen e aktiviteteve në hapësire për një periudhë mbi 20 vjeçare.
- *Strategjia e Zhvillimit Rajonal* për synimet e mijëvjeçarit Shkodër dhe Lezhë
- Me mbështjen e bashkëpunimit Teknik Gjerman (GTZ), qarku Shkodër ka përpunuar *Konceptin e Zhvillimit Rajonal*, i cili shërben si dokument kryesor strategjik për qarkun. Dokumenti i miratuar rëndit pesë priorite kryesore për zhvillimin rajonal: - arsimin, trajnimi dhe ndërtimi i kapaciteteve; infrastruktura dhe shërbimet; turizmi dhe agroturizmi; bashkëpunimi rajonal; përblyjet.
- Në këtë kontekst me ndihmën e partnerëve rajonal të programit PNUD – ART GOLD 2, në bashkëpunim me Këshillin e Qarkut Shkodër u hartua *Planin Strategjik për Turizmin e Qëndrueshëm*.
- Po në zbatim të objektivave të Konceptit të Zhvillimit Rajonal për përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve, konkretisht atë të fëmijëve, Këshilli i Qarkut Shkodër në bashkëpunim me UNICEF hartoja *strategjinë dhe planin e veprimit rajonal përfshi fëmijët*.

Qarku Shkodrës duke qenë një rajon kufitar, me një traditë të hershme të shkëmbimeve dhe bashkëpunimit ekonomik por jo vetëm ekonomik, me rajonet e vendeve të tjera dhe aktualisht, një rajon i cili është në fokusin e disa programeve evropiane të bashkëpunimit ndërkufitar, është angazhuar në një proces intensiv përafrimi me instrumentet e BE.

Këshilli i Qarkut Shkodër ka qenë pjesë e zbatimit të disa projekteve, të finançuara nga BE me anë të programeve Ipa-Adriatic cbc, Interreg-Med apo Cross-Border me Malin e Zi etj.

Secili nga këto projekte minimalisht kanë pasur një numër të madh partneresh, nga tetë vende të ndryshme. E thëne ndryshe në sajë të këtyre programeve, sot kemi krijuar lidhje pune, me shumë partnere nga e gjithë zona Adriatiko-Joniane e më gjerë. Në këtë kontekst jemi të bindur se të gjithë partneret përfitues të Programeve Europiane, kanë krijuar tashmë një njohje dhe një eksperience të pasur, si rezultat të pures së përbashkët.

Shumë faktorë e bëjnë të rëndësishëm zgjerimin dhe jo fragmentimin e bashkëpunimit në zonën e Adriatikut-Jonit, veçanërisht kur bëhet fjalë për zbatimin e një strategjje inter-aktive sikurse strategjia EUSAIR, ndaj dhe të gjithë aktorët, duhet të ngulmojnë dhe të rrisin bashkëpunimin ndërmjet tyre për të kthyer në veprime.

Afërsia gjeografike dhe kulturore, mundëson intensifikimin e marrëdhënieve shumëpalëshe midis rajoneve bregdetare të Adriatik-Jonit për të mbështetur proceset lokale të rritjes harmonike, zhvillimin e qëndrueshëm dhe unitetin midis popujve duke e intensifikuar komunikimin ndërmjet tyre dhe mos duke krijuar ndarje në programet e BE, të cilat pastaj ndikojnë direkt në territor.

Kjo do ishte një rrugë që forcon akoma më shumë besimin dhe bashkëpunimin tonë territorial. Ajo do rrisë njohuritë dhe kompetencat e Administratave tona Publike dhe të gjithë aktorëve të përfshirë, si një vlerë e nevojshme jo vetëm për zbatimin e strategjisë EUSAIR, por edhe të integrimit të plotë të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE.

2.3 Sfidat kryesore të Zhvillimit /Paraqitja e projekteve kryesore–arsyet dhe përfituesit

Mbeshtetur ne strategjine sektoriale të qarkut Shkodër si dhe vendimeve të marra nga Këshilli i Qarkut Shkodër “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2022”, projektet të cilat janë planifikuar për vitin 2022 dhe në PBA-në 2023-2025 janë;

- Ndërtim I Ujësjellësit ne fshatin Muriqan, si pjese e Bashkise Shkoder ne fshatin Muriqan, i cili konsiderohet një nder priorititet e Bashkise Shkoder per permiresimin e jetës në komunitet. Permes këtij investimi, synohet ndikimi pozitiv ne zhvillimin ekonomiko social të zonës. Vlera e ketij Projekti investimi është 98,181 mijë lekë .
- Investimi Sistemim, Asfaltim i rrugeve të brendshme në Fshatin Nënshatë” , Bashkia Vau Dejës me vlerë investimi 14,750,000 lekë, prioritet i Bashkisë Vau Dejës dhe i KQShkodër.
- Investimi “Sistemim, asfaltim rruga kryesore e varrezave ne fshatin Kalldrur” ,Bashkia Malësi e Madhe me vlerë investimi 6,000 mijë leke, prioritet i Bashkisë Malësi e madhe dhe e KQShkodër.
- Investimi”Rrethim e Sistemim i varrezave publike te Qytetit Pukes”, Bashkia Pukë, investim ky që do të realizohet në vitit 2022 në vlerën 7,319 mijë lekë dhe 2023 me vlerë 7,000 mijë lekë .Është Prioritet I Bashkisë Pukë që ne vitin 2020 dhe perioitet I KQShkodër.
- Per tre vitet e ardhshme kemi planifikuar fonde në Programin 04520, përikonstruksione rrugësh në mbështetje të prioriteve që do paraqiten nga bashkitë e qarkut Shkodër, të cilat do të vendosen me vendim këshilli si dhe ne Programin 06370 përfundimin e investimit të ujësjellësit të Muriqanit.

2.3 Plani i shpenzimeve kapitale /projektplani 2023-2025

SHPENZIMET KAPITALE

| | | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 |
|----------------|--|---------------|--------------|---------------|---------------|---------------|---------------|
| Programi 01110 | Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi | 195 | 201 | 7,619 | 8,400 | 500 | 500 |
| Programi 01160 | Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi-DAMT | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Programi 04520 | Rrjeti rrugor Rural Transporti | 12,507 | 3,568 | 23,362 | 0 | 18,391 | 37,433 |
| Programi 04130 | Mbështetje për zhvillimin Ekonomik- Fonde projektsh me Finacim të Huaj | 235 | 932 | 2,235 | 0 | 0 | 0 |
| Programi 06370 | Furnizimi me ujë dhe Kanalizime | 790 | 200 | 60,526 | 24,878 | 16,980 | 0 |
| Programi 10430 | Përkujdesje Sociale | | | | | | |
| Total | | 13,727 | 4,901 | 98,643 | 33,278 | 35,871 | 37,933 |

Këshilli i Qarkut Shkodër me Vendimin nr.3, datë 06/04/2022 ka bërë miratimin tavaneve Përgatitore të Shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025, të ndarë në programe dhe që do të finalozohen me buxhetin e vitit 2023.

3. Informacion financiar

3.1 Burimi i të ardhurave

Burimi i të ardhurave të Këshillit të Qarkut Shkodër përbëhet nga;

- **Transferta e Pakushtëuar nga Buxheti i shtetit** e cila siç shihet edhe nga tabela C1, e bazuar në formulën e shpërndrjes së kësaj transferte për qarqet dhe e miratuar në ligjin e buxhetit vjetor në vitin 2022 eshtë rritur në masën rreth 2% në krahasim me vitin 2021. Për tre vitete në vazhdim 2023, 2024 dhe 2025 kjo transfertë është parashikuar përkatësisht; përvitin 2023, transferta e pakushtëuar është parashikuar në vlerë absolute 61,858 mijë lekë ose rreth 7% me e lartë se ajo e vitit 2022, në vitin 2024, është parashikuar në masën 64,951 mijë lekë ose rreth 5% me e lartë se ajo e vitit 2023, ndërsa përvitin 2025 transferta e pakushtëuar është parashikuar në vlerë absolute 67,013 mijë lekë ose rreth 3% me e lartë se ajo e vitit 2024.
- **Transferta e kushtëuar** e cila çdo vit i delegohet qarqeve për Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, funksion ky deleguar me ligj. Çdo fillim vitit Ministria e Brendshme bën transferimin e ketij fondi, rritmi i rritjes i së cilit është bërë në përputhje me rritmet e rritjes së pagave dhe nivelin e zhvillimit ekonomik. Me këto fonde plotësohen nëvojat per kosto pëersoneli dhe disa shpenzime operative, të këtij funksioni. KQShkoder me të drejten që ligji ja jep, plotëson çdo nevojë qe i paraqitet kësaj drejtorie. Për vitet 2023-2025, kjo transfertë është parashikuar në masën 5,613 mijë lekë në vit, pavarësisht ndryshimeve që mund të ketë kjo transferte, kur vjen nga Ministria e Brendshme.

➤ Të ardhurat nga **tarifat e shërbimeve** të miratuara me vendime keshilli per qarqet Jane mjaft të kufizuara, ne zbatim te kompetencave qe qarqet kane sipas ligjit.Këto zënë një përqindje të pakonsiderushme në totalin e të ardhurave vjetore. Planifikimi i tyre është bërë duke marrë në reference periudhat paraardhëse dhe duke shtuar rritmet e rritjes ekonomike.Megjithatë planifikimi i tyre ka vend për rishqyrtim. Për vitin 2022 , të ardhurat nga shërbimet janë ulur në masen 50% të tyre si rezultat i uljes së kërkeseve për këto shërbime. Për tre vitet në vazhdim të ardhurat këto të ardhura janë planifikuar 150 mijë lekë në vit por përsëri realizimi i tyre varet nga kërkesa që ka komuniteti per tu paisur më dokumente qe institucioni yne disponon në varësi të ndryshimeve ligjore.

➤ **Qarku financohet nga kuotat e anëtarësisë së bashkive përbërese të cilat përcaktohen në buxhetin e tyre vjetor. Meqenëse përcaktimi i kësaj kuote vendoset nga këshillat e bashkive në buxhete vjetore si dhe varet nga të ardhurat që bashkitë arkëtojnë edhe vendosja e kësaj kuote është relative.**

Planifikimi i kësaj takse për periudhën 2023-2025, është parashikuar në masen e mundësisë qe Bashkitë mund të planifikojne për Taksën e Qarkut, në varësi të treguesve te tyre ekonomike si dhe duke u mbështetur në faktin e vitiit 2021.

3.2 Shpenzimet

01.Shërbime të Përgjithshme Publike.

Në programin **01110 “Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi”**, Duke parë shifrat ne tabelen 4-1, vërejme se shpenzimet sipas zërave, nuk kanë shumë ndryshime. Në artikullin paga, planifikimi I vitit 2023 është bërë ashtu si në vitin 2022 pasi edhe numri I punonjësve është I pandryshueshem. Planifikimi per vitin 2024 dhe 2025 në këtë artikull është rritur rrëth 2.7%, kjo duke parashikuar ritmet e rritjes ekonomike.

Shpenzimet korrente per tre vitet janë te njeja duke u bazuar ne planin e vitit 2022.

Në Investimet për vitin 2023, eshtë përfshirë investimi I planifikuar në vitin 2022 që është I ndarë në dy vite.

Në kete program eshtë përfshirë edhe programi 01160, ku janë fondet që vijnë përfunksionin e deleguar prane Këshillit të Qarkut Shkoder, DAMT nga Ministria e Brendshme.

Kjo është Transfertë e Kushtëzuar që përdoret sipas destinacionit që vjen dhe në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Prandaj dhe planifikumi i saj në vitet 2023-2025 është bërë duke u bazuar në trasfertën e vitit 2022.

Në Programin **04520”Rrjeti rrugor rural”**, përfshihen investimet që parashikohen të kryhen në rrjetin rrugor rural për rikonstruksione rrugësh me fonde te miratuara nga Keshilli i Qarkut Shkodër sipas kërkeseve dhe prioriteteve të bashkive të qarkut Shkodër.

Në Programin 06370”Furnizimi me ujë”, përfshihen shpenzimet planikuara për invesimin “Ndërtim i ujësjellësit Muriqan” me vlore totale projekti 98,181 mijë lekë. Siç shihet, me vlerën e planifikuar të këtij viti dhe me fondet e planikuara ne PBA per vitet 2023 dhe 2024, ky investim do të përfundojë .

Siç shihet nga tabela 4-1, programi **04130”Mbështetje për Zhvillim Ekonomik”**, nga viti 2023 e ne vazhdim , janë planifikuar fonde te cilat kane te bejnë me disa projekte te BE-së në fushen e turizmit , për të cilat ne kemi aplikuar dhe keto shuma do shërbejne përbashkëfinancime me këto projekte për ecurine e tyre, sipas Udhezimit nr.35, date 21.09.2020.

3.4 Informacion finansiar suplementar

3.4.1 Huamarrje

Nuk kemi huamarrje apo kredi.

3.4.2 Detyrime të prapambetura

Nuk kemi detyrime të prapambetura, përvçese obligime fondesh për fatura të paparaqitura për likuidim.

3.4.3 Reziqet financiare dhe fiskale

Duke parë se të ardhurat tona janë shumë të kufizuara , edhe planifikimi i tyre bëhet në ato zëra buxheti ku nuk paraqesin rreziqe financiare.Kjo ka sjelle edhe atë që ne nuk kemi detyrime te prapambetura financiare.

4 Monitorimi i zbatimit të strategjisë së zhvillimit te NJQVendore.

4.1 Lista e masave strategjike për çdo fushe prioritare-statusi i zbatimit

| FUSHA PRIORITARE | MASA STRATEGJIKE | STATUSI I ECURISE |
|---|---|---|
| “Edukim, trajnim dhe ndërtim kapacitetesh” | Forcimi i kapaciteteve dhe burimeve njerëzore të institucioneve lokale e rajonale | Jane zhvilluar trajnime te ofruara nga ASPA si dhe nga Agjensi te ndryshme qe lidhen me Zhvillimin, Emergencat, Projektet, finançen per te rritur kapacitetet me tej kapacitetet institucionale |
| “Infrastruktura Shërbimet | Km të rrugëve rurale të përmirësuara në nivel Qarku | Ne kuader te zhvillimit ekonomik te zonave ruarale eshte financuar ndertimi i rrugëve ne Qarkun e Shkodres, keto investime kane permiresuar aksesin e banoreve te zonave perfituese drejt tregjeve rajonale, institucioneve arsimore si dhe kane bere te mundur permiresimin e standartit ekonomik te zones |
| “Turizmi dhe Agrobiznesi” me fushë veprimi | Përcaktimi, menaxhimi dhe promovimi destinacioneve turistike në të gjithë rajonin | Ne bashkepunimin me njesite vendore jane percaktuar konsoliduar hartat ne te cilat oforhen sherbimet turistike si dhe ato sociale |
| Bashkëpunimi ndër-vendor dhe bashkëpunimi me partnerë të tjera” | Hartimi projekteve dhe realizimi projekteve në partneritet | Ne vazhdimesi jane hartuar projekte me fonde te BE, ne dy tre programme te BE me fokus nderkufitar dhe nderajonal. Po punohet per aplikime në projekte te reja. |

| | | | |
|------------------------|-----------------------------|-----------|---|
| “Mbrojtja përmbytjeve” | kundër Rivitalizimi prekura | zonave të | Pjesemarrje dhe mbeshtetje ne bashkepunim me NJQV e programeve te ndryshme te trajnimit me mbeshtetjen e organizatave per trajnimin e popullsise dhe stafeve per minimizimin e rasteve te fatkeqesive natyrore. |
|------------------------|-----------------------------|-----------|---|

5.Shtojcë

-Treguesit Kryesorë të kuadrit Makroekonomik e fiscal 2023-2025

Transferta e Pakushtëzuar , është e ardhura kryesore që këshilli Qarkut Shkodër, bazuar në shtojcën 1 të udhëzimit nr.8, datë 28/02/2022, paraqitet si më poshtë;

Transferta e pakushtëzuar për vitin 2023 është parashikuar në vlerë absolute **61,858 mijë** lekë ose rrëth 7% me e lartë se ajo e vitit 2022,

Për vitin 2024, është parashikuar në masën **64,951 mijë** lekë ose rrëth 5% me e lartë se ajo e vitit 2023,

Për vitin 2025 transferta e pakushtëzuar është parashikuar në vlerë absolute **67,013 mijë** lekë ose rrëth 3% me e lartë se ajo e vitit 2024.

Qarqet nuk përfitojne transferte të Pakushtëzuar Sektoriale, por vetem Transfertë të Kushtëzuar me destinacion.

Paketa fiskale e qarqeve është e përbërë nga **tarifat e shërbimeve** që është pothuaj e pakonsiderushme në totalin e të ardhurave të qarkut dhe kuota e qarkut që bashkitë derdhin në favor të saj sipas vendimit të Këshillit Bashkiak respektiv.Keshilli Bashkiak vendos për shumën e kuotës së qarkut

- Grupi për Menaxhim Strategjik, Ekipi i Menaxhimit të Programeve-Përbërja dhe Roli i tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 10296,datë 8/7/2010”Për menaxhimin finanziar dhe kontrollin”i ndryshuar, dhe udhëzimit nr. 23, datë 30/07/2018”Për procedurat standarte të Përgatitjes së PBA në NJQV” është ngritur Grupi për Menaxhim Strategjik me Urdhërin e Brëndshëm nr. 4, datë 16.02.2022.

Kryetar i GMS është Kryetari i KQShkoder.

Koordinator i GMS është Zëvendëskryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër.

Sekretar i GMS është Nëpunësi Zbatuesi KQShkodër.

Anëtarët e tjerë të GMS janë specialistë të lartë të fushave përkatëse, përgjegjës për menaxhimin e projekteve/aktiviteteve që ato drejtojnë. Këto janë përgjegjës për realizimin e detyrave teknike për zbatimin e proçeurave të përgatitjes së kërkësave buxhetore që lidhen me programin e tyre.Këto specialistë luajnë rolin e EMP-së si rezultat i numrit të kufizuar të punonjësve në qarqe, i miratuar në ligjin vjetor të buxhetit.

Menaxhimi i brëndshëm i proçesit të përgatitjes së PBA-së brënda NJQV bazohet në vendimmarrjen e GMS.

Bashkangjitur relacionit janë përgatitur kërkesat buxhetore në nivel produkti për PBA-në 2023-2025 për programet që Këshilli Qarkut Shkodër planifikon për shpenzimet buxhetore.

Nëpunësi AUTORIZUS

Hilmi LAKTI



Nëpunësi ZBATUES

Gjyljana MIRUKU

A blue ink signature of 'Gjyljana MIRUKU' is shown next to her name.



Tavanet e PBA - 2023-2025

| Planifikimi i Shpenzimeve të Programit | | | 2023-2025 | TAVANET | | |
|--|---|------------------|---|--|---|----------|
| 2023-2025 | Tavanet e PBA për institucionin dhe Tavanet e Programit | | | | | |
| Emri i Entit: | KESHILLI I QARKUT SHKODER | | | | | |
| Numri i Grupit: | | | | Mijë Lekë | | |
| Tavani i Institucionit | | | Buxheti | | PBA 2023-2025 | |
| TOTALI | Emri i Artikullit | Nr. i Artikullit | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 |
| | Paga | 600-601 | 22,813.0 | 22,813.0 | 23,313.0 | 23,313.0 |
| | Korente të tjera | 602-606 | 15,497.0 | 13,380.0 | 13,380.0 | 13,380.0 |
| | Kapitale | 230-231 | 89,567.0 | 33,278.0 | 35,871.0 | 37,933.0 |
| | Jashtë-buxhetore | | 8,892.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 |
| Alokimi i Tavanit për Programet | | | Buxheti | | PBA 2023-2025 | |
| Emertimi i Programit Planif.menaxh.administrim | Emri i Artikullit | Nr. i Artikullit | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 |
| | Paga | 600-601 | 17,500.0 | 17,500.0 | 18,000.0 | 18,000.0 |
| | Korente të tjera | 602-606 | 14,536.0 | 12,480.0 | 12,480.0 | 12,480.0 |
| | Kapitale | 230-231 | 7,619.0 | 8,400.0 | 500.0 | 500.0 |
| | Jashtë-buxhetore | | 610.0 | | | |
| Alokimi i Tavanit për Programet | | | Buxheti | | PBA 2023-2025 | |
| Emertimi i Programit Zhvillimi i Turizmit | Emri i Artikullit | Nr. i Artikullit | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 |
| | Paga | 600-601 | | | | |
| | Korente të tjera | 602-606 | 661.0 | 600.0 | 600.0 | 600.0 |
| | Kapitale | 230-231 | | | | |
| | Jashtë-buxhetore | | 2,235.0 | | | |
| Alokimi i Tavanit për Programet | | | Buxheti | | PBA 2023-2025 | |
| Emertimi i Programit Rrjeti rrugor rural | Emri i Artikullit | Nr. i Artikullit | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 |
| | Paga | 600-601 | | | | |
| | Korente të tjera | 602-606 | | | | |
| | Kapitale | 230-231 | 23,362.0 | 0.0 | 18,391.0 | 37,433.0 |
| | Jashtë-buxhetore | | | | | |
| Alokimi i Tavanit për Programet | | | Buxheti | | PBA 2023-2025 | |
| Emertimi i Programit Furnizimi me uje | Emri i Artikullit | Nr. i Artikullit | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 |
| | Paga | 600-601 | | | | |
| | Korente të tjera | 602-606 | | | | |
| | Kapitale | 230-231 | 58,586.0 | 24,878.0 | 16,980.0 | 0.0 |
| | Jashtë-buxhetore | | | | | |
| Alokimi i Tavanit për Programet | | | Buxheti | | PBA 2023-2025 | |
| Emertimi i Programit DAMT | Emri i Artikullit | Nr. i Artikullit | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 |
| | Paga | 600-601 | 5,313.0 | 5,313.0 | 5,313.0 | 5,313.0 |
| | Korente të tjera | 602-606 | 300.0 | 300.0 | 300.0 | 300.0 |
| | Kapitale | 230-231 | | | | |
| | Jashtë-buxhetore | | | | | |
| Alokimi i Tavanit për Programet | | | Buxheti | | PBA 2023-2025 | |
| Emertimi i Programit Ministria e Shendetësise | Emri i Artikullit | Nr. i Artikullit | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 |
| | Paga | 600-601 | | | | |
| | Korente të tjera | 602-606 | | | | |
| | Kapitale | 230-231 | | | | |
| | Jashtë-buxhetore | | 6,047.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 |
| Alokimi i Tavanit për Programet | | | Buxheti | | PBA 2022-2024 | |
| Emertimi i Programit Nr. Titullit Programor | Emri i Artikullit | Nr. i Artikullit | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 |
| | Paga | 600-601 | | | | |
| | Korente të tjera | 602-606 | | | | |
| | Kapitale | 230-231 | | | | |
| | Jashtë-buxhetore | | 6,047.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 |
| Miratimi | | | Nepunesi Zbatues Emri: Nënshtkrimi: Data: | Nepunesi Autorizues Emri: Nënshtkrimi: Data: |  | |

KESHILLI QARKUT SHKODER
PERMBLEDHESE E TE ARDHURAVE

| Nr | Emertimi i të Ardhurave Tatimore | Fakti per vitin 2020 | Fakti per vitin 2021 | Buxheti per vitin 2022 | Buxheti per vitin 2023 | Buxheti per vitin 2024 | Buxheti per vitin 2025 |
|----|--|----------------------|----------------------|------------------------|------------------------|------------------------|------------------------|
| A | Të ardhura | | | | | | |
| I | Të ardhura nga tarifat | 906 | 92 | 150 | 150 | 150 | 150 |
| a | Tarifa për konfirmim hartash | 41 | 43 | 50 | 50 | 50 | 50 |
| b | Tarifa për shembime administrative(dok. Arshivore) | 29 | 9 | 50 | 50 | 50 | 50 |
| c | Tarifa shembim Kadastral | 47 | 40 | 50 | 50 | 50 | 50 |
| d | Teardhura te ijera | 790 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| II | Të ardhura te ndryshme | 143 | 1,140 | 0 | 1,850 | 1,850 | 1,850 |
| a | Te ardhurat nga kuota vjetore e bashkive | 143 | 1,140 | 1,850 | 1,850 | 1,850 | 1,850 |
| A | Totali i te ardhurave te veta (I+II) | 1,049 | 1,232 | 150 | 2,000 | 2,000 | 2,000 |
| B | Transfera e pakushtezuar | 37,449 | 23,485 | 57,734 | 61,858 | 64,951 | 67,013 |
| E | Te trasheguara | 320 | 3,568 | 64,990 | 0 | 0 | 0 |
| C | Transfera e kushtezuar DAMT | 5,207 | 4,973 | 5,613 | 5,613 | 5,613 | 5,613 |
| C1 | Transfera e kushtezuar Shtetia FACIBENI | 1,993 | 5,242 | 6,047 | 0 | 0 | 0 |
| C2 | Transfera e kushtezuar AGJENC KONB UJB | 0 | 0 | | | | |
| D | Financime te huaja | 235 | 932 | 2,235 | 0 | 0 | 0 |
| | ADRIATICAVES (Thesari) | 0 | 747 | 2,235 | 0 | 0 | 0 |
| | ADRIATICAVES (Banka nivelit dyte) | 235 | 185 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Totali I te ardhurave (2022-2024) | 45,204 | 38,200 | 136,769 | 69,471 | 72,564 | 74,626 |

Nëpunësi Zbatues
Gjyljana MIRUKU



Hilmi LAKTI